

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6512  
E martë, 18 janar 2022  
çmimi 0.40 €

**Kritja e rasteve  
çon shkollën  
në mësim online** | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

**KA VAZHDIJË DEBATI NË MES TË POZITËS DHE OPOZITËS  
PËR REFERENDUMIN SERB** | FAQE 4-5

## OPOZITA: QEVERIA NUK ËSHTË SQARUAR ME ALEATËT PËR REFERENDUMIN SERB



Subjektet opozitare kanë vlerësuar se Qeveria e Kosovës nuk është koordinuar me bashkësinë ndërkombëtare për refuzimin e mbajtjes së referendumit serb në Kosovë. Shefat e grupeve parlamentare të PDK-së dhe të AAK-së kanë vlerësuar se përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës nuk kanë ofruar argumentet e duhura para partnerëve strategjikë për këtë çështje. Sipas tyre, në këtë mënyrë mund të dëmtohen raportet me aleatët. Përfaqësuesit e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, kanë mohuar mundësinë e prishjes së raporteve të Kosovës me ShBA-në dhe BE-në

### AKTUALE



**TË ENJTEN KUVENDI MBLIDHET  
NË SEANCË PLENARE** F. 5

**KDI-ja: NËNSHKRIMI I  
KONTRATAVE AFËR MUAJIT TË  
ZGJEDHJEVE, JOPARIMOR** F. 3

**HARADINAJ KUNDËRSHTON  
ASHPËR SHTRENTJIMIN  
E RRYMËS ELEKTRIKE** F. 3



### EKONOMI



**BIZNESET QË DËMTOJNË SHTETIN** F. 8

**FILLON PUNËN NDËRMARRJA  
SHOQËRORE BREZOVIÇA** F. 8

### SPORT



**STINORI PRANVEROR FILLON ME  
DUELE SHUMË INTERESANTE** F. 10

**Ministria e Shëndetësisë  
bën thirrje për respektim  
të masave kundër Covidit**

| FAQE 3



**ERDOGANI VLERËSON RAPORTET  
E NGUSHTA ME SHQIPËRINË**

| FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVIÇË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Erdogani vlerëson raportet e ngushta me Shqipërinë

**TIRANË, 17 JANAR** - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka vizituar të hënën Shqipërinë. Ai ka marrë pjesë në ceremoninë e dorëzimit të banesave të ndërtuara nga qeveria turke për personat që mbetën pa strehë pas tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019 në qytetin e Laçit. Presidenti turk përuroi 522 banesat që Turqia ndërtoi në Laç, të cilat u tha se kushtuan afër 42 milionë euro. Gjatë ceremonisë së dorëzimit të këtyre banesave, Erdogan foli për afërsinë mes dy vendeve dhe "ndjenjën e vëllazërisë" që ato kanë mes vete. "Duke qenë se edhe populli turk

ka përjetuar dhimbje të ngjashme, tërmetet e shtatorit dhe nëntorit lënduan zemrat tona njëllor si të popullit shqiptar. Fakti që Turqia është nga vendet e para që i erdhi në ndihmë Shqipërisë është dëshmi e qartë e solidaritetit të fortë mes nesh", ka pohuar Erdogan. Nga Laçi, Erdogan adresoi edhe situatën me pandeminë e koronavirusit, ku tha se shtetet e fuqishme të botës nuk kanë pasur qasje të drejtë ndaj vendeve më të varfra. "Gjatë pandemisë të gjitha shtetet e mëdha u kyçën dhe mbyllën edhe sytë e tyre, por ne bëmë të kundërtën, dolëm edhe

jashtë kufijve për t'i parë dramën e vëllezërve tanë për t'u qëndruar pranë me çdo mundësi", ka deklaruar Erdogan. Po në Laç presidenti turk mori pjesë në ceremoninë e emërimit të sheshit të qytetit me emrin e tij. Më pas Erdogan u takua në Tiranë me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Të dy liderët më pas nënshkruan shtatë marrëveshje, memorandume mirëkuptimi dhe protokolle bashkëpunimi në fusha të ndryshme. Presidenti turk, Rexhep Taip Erdogan, u shpall "Qytetar Nderi i Kurbinit".



## Abazoviqi propozon krijimin e një qeverie të pakicës



**PODGORICË, 17 JANAR** - Lëvizja Qytetare Ura dhe Lidhja e Qytetarëve CIVIS, që garuan në zgjedhjet parlamentare në Mal të Zi të mbajtura vitin e kaluar në kuadër të listës "E zeza mbi të bardhë", propozuan formimin e një qeverie të pakicës, si model për tejkalimin e krizës politike në këtë shtet. Sipas këtij modeli të propozuar, në këtë qeveri nuk do të kishte vend për partinë më të madhe opozitare, Partinë Demokratike të Socialistëve (DPS) dhe partinë më të fortë të koalicionit aktual, Frontit Demokratik (DF), parti pro-serbe. Qeveria aktuale e kryeministrit

Zdravko Krivokapiq që nga fillimi i mandatit ka qenë në shënjestër të kritikave dhe pengesave nga strukturat e shumicës qeveritare, në radhë të parë nga Fronti Demokratik, i cili në disa raste ka kërkuar që të zgjidhet një qeveri i ri. Zëvendëskryeministri i Malit të Zi dhe lideri i Lëvizjes Ura, Dritan Abazoviqi, tha në një konferencë për medie se të gjithë deputetët e Parlamentit malazez duhet ta përkrahin modelin e një qeverie të pakicës. Ai porositi që për DPS-në dhe DF-në nuk ka vend në këtë qeveri, por "do të ishte fenomenale nëse do të na përkrahnin". "Ne ofrojmë një zgjidhje të mundshme,

por nuk e imponojmë. Është koha që të zhbllkohet rruga për në Bashkimin Evropian. Nëse kjo situatë nuk mund të zgjidhet, zgjedhjet mbeten zgjidhje e qartë", tha Abazoviqi. Ai shtoi se në rast se sigurohet mbështetja e shumicës në Kuvend, do të iniciohet mocioni i votëbesimit të qeverisë aktuale. Ideja për formimin e një qeverie të pakicës u përmend për herë të parë në vjeshtën e kaluar pasi që dështuan negociatat për riorganizimin e qeverisë dhe një platformë e ofruar nga DF, që parashikonte zgjedhjen e një kryeministri të ri.

## Gjermania: Zgjidhja e tensioneve Rusi - Ukrainë, vetëm përmes diplomacisë

**BERLIN, 17 JANAR** - Ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, tha se diplomacia është "mënyra e vetme" për t'i zgjidhur tensionet midis Moskës dhe Perëndimit lidhur me Ukrainën. Këto komente ajo i bëri gjatë një vizite në Kiev, prej ku paralajmëroi Rusinë se do të paguante "çmim të lartë" nëse sulmon Ukrainën. "Ne do të bëjmë gjithçka që ta garantojmë sigurinë e Ukrainës. Ne do të bëjmë gjithçka që ta garantojmë sigurinë e Evropës", tha Baerbock gjatë konferencës së

përbashkët për medie me homologun e saj ukrainas, Dmytro Kuleba. "Çdo veprim i mëtejshëm agresiv do të ketë çmim të lartë për Rusinë në aspektin ekonomik, strategjik dhe politik", tha ministrja gjermane një ditë para se ajo të takohet në Moskë me homologun e saj Sergei Lavrov. Më 2014 Rusia aneksoi Gadishullin ukrainas të Krimesë dhe që atëherë mbështet luftëtarët separatistë që po luftojnë me forcat qeveritare ukrainase në Lindje të Ukrainës. Nga ky konflikt janë vrarë mbi 13

200 persona. Kievi dhe Perëndimi thonë se Rusia ka dislokuar dhjetëra mijëra trupa përgjatë kufirit me Ukrainën dhe kanë ngritur shqetësime se Moska është duke u përgatitur për një pushtim të mundshëm. Por, Moska mohon se po përgatitet që ta pushtojë Ukrainën. Gjatë javës së kaluar janë mbajtur takime ndërmjet Rusisë dhe shteteve perëndimore lidhur me grumbullimin e trupave ruse, por këto bisedime nuk kanë prodhuar ndonjë rezultat konkret.



## Kina ul normat e interesit pas ngadalësimit të rritjes ekonomike

**PEKIN, 17 JANAR** - Kina ka ulur normat e interesit për herë të parë në gati dy vjet, pasi të dhënat zyrtare kanë treguar për ritme të ngadalshme të rritjes ekonomike. Për të ndihmuar në nxitjen e ekonomisë, Banka Popullore e Kinës ka thënë se do ta ulë normën e interesit për kreditë njëvjeçare në 2.85 për qind.

Bruto-prodhimi i brendshëm (GDP) është rritur për 4 për qind në tre muajt e fundit të vitit 2021 në krahasim me një vit më herët, ka thënë Byroja Kombëtare e Statistikave. Ky rezultat ka qenë shumë më i mirë sesa parashikimet e disa ekonomistëve, mirëpo rritja ka qenë shumë më e ngadalshme sesa çereku paraprak.



Një tjetër shenjë e trendeve në ulje ka qenë edhe ajo e rënies së shitjeve me pakicë për 1.7 për

qind. Sa i përket gjithë vitit, të dhënat zyrtare kanë treguar se ekonomia e Kinës është rritur për 8.1 për qind, duke tejkaluar edhe pritjet e ekonomistëve dhe synimeve të Pekinit për rritje rreth 6 për qind. Veprimet e Kinës për ulje të normave të interesit e vendosin atë anash vendimeve të bankave

të mëdha qendrore në botë. Rezervat Federale të Shteteve të Bashkuara kanë thënë se planifikojnë t'i rritin normat e interesit tri herë këtë vit. Në Mbretëri të Bashkuar, Banka e Anglisë ka rritur normat e interesit muajin e kaluar, për herë të parë në më shumë se tri vjet, me qëllim të luftimit të rritjes së çmimeve.



# KDI-ja: Nënshkrimi i kontratave afër muajit të zgjedhjeve, joparimor

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 JANAR - Me pjesëmarrjen e kryesuesve të kuvendeve të komunave, drejtorë të drejtorive komunale për ekonomi dhe financa, zyrtarë të drejtorive për ekonomi dhe financa, zyrtarë të prokurimit si dhe anëtarë të kuvendeve të komunave, është mbajtur tryeza me temën "Shpenzimet e parasë publike në kategorinë e subvencioneve dhe investimeve kapitale gjatë mandatit qeverisës 2018-2021".

Qëllimi i organizimit të kësaj tryeze ishte publikimi i raportit të shpenzimeve të parasë publike në dy kategoritë buxhetore gjatë mandatit të kaluar qeverisës në shtatë komunat më të mëdha të Kosovës si dhe diskutimi i të gjeturave me aktorë menaxhues dhe vendimmarrës në nivel lokal për t'i adresuar të gjeturat e raportit me qëllim të reflektimit në një menaxhim më të mirë të parasë publike në përgjithësi.

Naim Cahani, zyrtar i KDI-së, duke elaboruar metodologjinë e

hulumtimit dhe të gjeturave në raport, ka thënë se komunat gjatë mandatit qeverisës kanë vazhduar të kenë trend të rritjes të planifikimit buxhetor. "Në mesin e shtatë komunave më të mëdha që janë pjesë e këtij hulumtimi, komuna e Mitrovicës së Jugut mbetet një ndër komunat e cila kishte trend më të madh të rritjes së planifikimit të buxhetit krahasuar me vitin e parë dhe të fundit të mandatit qeverisës me 19.88 për qind. Si komunë e dytë me rritjen më të madhe të planifikimit të buxhetit mbetet komuna e Prishtinës me 18.70 për qind derisa komuna e Prizrenit mbetet një ndër komunat që kishte një trend më të vogël të rritjes së buxhetit të komunës krahasuar me vitin e parë dhe të fundit të mandatit qeverisës me vetëm 5.9 për qind rritjeje", është shprehur Cahani, duke krahasuar shpenzimet e komunave në dy kategoritë buxhetore (subvencione dhe investime kapitale). "Nga viti i parë deri në vitin e fundit të mandatit qeverisës për periudhën janar - shtator shohim një trend ngritje dhe rënie

të shpenzimeve ndër vite", ka pohuar ai.

Sipas këtij hulumtimi, Komuna e Prishtinës mbetet një ndër komunat e cila ka rritje prej 640.80-përqindësh të shpenzimeve në këtë kategori buxhetore të subvencioneve, pasur nga komuna e Prizrenit me 154.45 për qind dhe ajo e Ferizajt me 139.22 për qind. "Komunat që kanë pasur më pak rritje të shpenzimeve në këtë kategori buxhetore janë komuna e Gjilanit me 1.72 për qind dhe ajo e Pejës me 16.79 për qind. Krahasuar periudhën janar - shtator 2021 me periudhën e njëjtë të vitit 2018, komuna e Gjilanit mbetet ndër komunat e cila ka rritje prej 103.63-përqindësh në kategorinë e investimeve kapitale, përcjell nga komuna e Gjakovës me 11.13 për qind. Krahasuar me periudhën janar - shtator 2021 me periudhën e njëjtë të vitit 2018, komuna e Mitrovicës së Jugut mbetet komuna e cila ka shpenzuar 19.70 për qind më pak në këtë kategori buxhetore si dhe komuna e Prizrenit dhe ajo e Prishtinës", ka thënë Cahani.

Ai ka shtuar se nga analizimi i të

dhënave në kategorinë e kontratave për punë të realizuara gjatë periudhës janar - shtator 2021, qeveria lokale e Prizrenit, Pejës, Ferizajt, Mitrovicës së Jugut, Gjilanit dhe Gjakovës kanë përqendruar aktivitetet e njoftimit për dhënie të kontratës dhe nënshkrimin e kontratës afër muajit zgjedhor.

"Praktikë kjo e cila mund të konsiderohet si mundësi e shfrytëzimit të pushtetit për të ndikuar në vullnetin e qytetarëve në proceset zgjedhore. Nga të gjeturat, rezultojnë që e vetmja qeveri komunale është ajo e Prishtinës e cila nuk ka përqendruar aktivitetet e saj në dhënie dhe nënshkrimin e kontratave afër muajit zgjedhor në kategorinë e kontratave për punë", ka theksuar Cahani.

Isa Osmankaj, menaxher i Zyrës së Prokurimit në komunën e Prizrenit, duke u pajtuar me të gjeturat e raportit, ka potencuar faktin se zyra e prokurimit është ngushtë e ndërlidhur me koordinimin ndërinstitucional. "Kjo mungesë e koordinimit na pamundëson t'i realizojmë aktivitetet e tërësishme të parapara në kuadër të planeve të

prokurimit. Duke mos mohuar ndikimet politike të përqendrimit të kontratave të lidhura afër muajit zgjedhor në vitin 2021 për shkak të zgjedhjeve, argumentoi faktin që duhet të bëhet më tepër për t'i specifikuar projektet në kodet të veçanta, dhe jo në kode të përgjithësuar siç ka ndodhur rëndom në të kaluarën", ka thënë ai. Diana Qarkagjia, anëtare e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, ka theksuar se të gjeturat në raportin e paraqitur qëndrojnë pasi, sipas saj, edhe në cilësinë e kuvendarëve kanë tërhequr vërejtjen për shtimin e angazhimit të komunës për të nënshkruar kontrata në muajt afër zgjedhjeve.

Zukë Zuka, nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ka thënë se edhe raportet e auditimit të jashtëm të nxjerra nga ZKA-ja janë me të njëjta probleme të atilla si: mosrespektimi i planit të prokurimit, vonesa në realizimin e projekteve, mosmbikëqyrja e duhur e realizimit të projekteve në terren, zotim jo të mjaftueshëm të mjeteve për realizimin e projekteve, vonesë në pagesa të caktuara dhe tejkallim të kontratave.



## Haradinaj kundërshton ashpër shtrenjtimin e rrymës elektrike

PRISHTINË, 17 JANAR - Kreu i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, i cili njëherësh është edhe deputet i Kuvendit të Kosovës, ka paralajmëruar se AAK-ja ka thirrur debat parlamentar për ngritjen enorme të çmimeve të artikujve elementarë.

Gjithashtu, ai ka njoftuar se ZRRE-ja ka ngritur një

propozim për shtrenjtim të rrymës, ku mund të mbërrijë mbi 80 për qind, propozim që Haradinaj e ka kundërshtuar ashpër. "Aleanca ka thirrur debat parlamentar për ngritjen enorme të çmimeve të artikujve elementarë për këtë të enjte. Ndërkohë veç paska rrjedhur një propozim i ZRRE-së për shtrenjtimin e rrymës që për konsumatorin mesatar familjar mund të

mbërrijë mbi 80 për qind. Kjo është e papërbalueshme. Prandaj i bëj thirrje qeverisë që në këtë periudhë kur inflacioni ka rritur çmimin e shportës së përditshme të qytetarëve, të ndajë buxhet për mbulimin e kostos shtesë nga çmimi i tanishëm i energjisë. Kjo s'duhet të mbetet në nivel diskutimi të papërcaktueshëm të qeverisë", ka thënë Haradinaj.







KA VAZHDUAR DEBATI NË MES TË POZITËS DHE OPOZITËS PËR REFERENDUMIN SERB

# Opozita: Qeveria nuk është sqaruar me aleatët për referendumin serb

Subjektet opozitare kanë vlerësuar se Qeveria e Kosovës nuk është koordinuar me bashkësinë ndërkombëtare për refuzimin e mbajtjes së referendunit serb në Kosovë. Shefat e grupeve parlamentare të PDK-së dhe të AAK-së kanë vlerësuar se përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës nuk kanë ofruar argumentet e duhura para partnerëve strategjikë për këtë çështje. Sipas tyre, në këtë mënyrë mund të dëmtohen raportet me aleatët. Përfaqësuesit e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, kanë mohuar mundësinë e prishjes së raporteve të Kosovës me ShBA-në dhe BE-në

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 17 JANAR** - Deputetët e opozitës kanë kritikuar qeverinë në raport me politikën e jashtme. Të hënën, pas mbledhjes së kryesisë së Kuvendit, ata kanë deklaruar se qeveria nuk është sqaruar mirë me partnerët strategjikë të Kosovës në lidhje me mosmbajtjen e referendunit serb në Kosovë.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka deklaruar qeveria nuk ka ofruar

argumentet e duhura para aleatëve ndërkombëtarë për referendumin serb. "Qeveria s'i ka ofruar argumentet e duhura përballë aleatëve tanë, përballë ShBA-së dhe kemi ardhur në një situatë ku kemi qëndruar të heshtur deri në momentin e fundit dhe, fatkeqësisht, aleatët tanë s'i kemi pasur për. Kjo ka ndodhur si pasojë e mosangazhimit", ka deklaruar Tahiri.

Sipas tij, kryeministri Kurti duhet të ripozicionohet për këtë çështje. "Sot me humb një betejë kundër Vuçiqit që kontrojnë

çdo pore të jetës nuk është e vështirë. Duhet të kemi një angazhim më serioz, njerëz më kompetentë. Kryeministri duhet të ripozicionohet, të ketë një angazhim më të madh në politikën e jashtme, kemi argumente edhe fakte të shumta që iniciativat serbe të mos përkrahen", ka thënë Tahiri. Sipas tij, mbajtja e seancës së jashtëzakonshme parlamentare për këtë çështje ka qenë e panevojshme. "Seanca ka qenë e panevojshme dhe unë e kam pa më shumë si tallje me deputetët e opozitës. Pikërisht sa i përket kësaj tallje, nuk kemi dashur të bëhemi pjesë e një seancë të tillë", ka deklaruar Tahiri.

Edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, i cili e ka përkrahur rezolutën, ka thënë se qeveria nuk është sqaruar me ndërkombëtarët për këtë çështje. "Qeveria do të duhej ta bëjë një shpjegim për opinionin e brendshëm dhe ta bëjë një shpjegim për opinionin e jashtëm, pra me faktorin ndërkombëtar me të cilin kemi punuar nga '99-ta. Argumentet e seancës së shtunës kanë qenë

argumentuese nga ana e palës sonë", ka vlerësuar Tahiri.

Ai ka bërë me dije se kjo parti do ta përkrahë qeverinë për çështjet të cilat janë në interesin kombëtar. "Ju e keni parë qartë se pozicioni i AAK-së për referendumin ka qenë parimor dhe i kemi dhënë mbështetjen qeverisë. Në tema të rëndësishme nuk do të jemi opozitë", ka thënë ai.

Tahiri ka deklaruar se në seancën e së shtunës nuk është dashur të ketë fare debat parlamentar. "Unë kam shkuar te kryetari i Kuvendit dhe i kam thënë se nëse kjo kthehet në një seancë ku deputetët tregojnë cili është më patriot se tjetri, atëherë ne do t'i tregojmë qeverisë për gabimet që i ka bërë gjatë gjithë kohës. Në temat kombëtare ku preket interesi i shtetit ne nuk bëjmë opozitë", është shprehur Tahiri.

## Pushteti mohon pretendimet e opozitës

Përfaqësuesit e partisë në pushtet kanë mohuar pretendimet e partive

opozitare. Ushtruesja e detyrës e shefit të grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka deklaruar se refuzimi i kërkesës së bashkësisë ndërkombëtare për referendumin serb nuk do të ndikojë në raportet e Kosovës me partnerët e saj. "Nuk e besoj fare se ka prishje të raporteve të Kosovës me partnerët ndërkombëtarë. Partneriteti nënkupton diskutim, dialogim, nganjëherë edhe mospajtim, por definitivisht përcaktim për rrugëtim të përbashkët. Kosova si projekt, para shpalljes së pavarësisë, pas shpalljes së shtetndërtimit është bashkë me partnerët ndërkombëtarë. Ne kemi parë edhe gjatë ditës së shtunës se partnerët ndërkombëtarë ishin bashkë me ne në përkujtimin e 23-vjetorit të masakrës së Reçakut", ka thënë Kusari-Lila. Ajo ka deklaruar se rezoluta e Kuvendit për mosmbajtjen e referendunit serb në Kosovë ka qenë vullnet i të gjitha partive politike. "Rezoluta e Kuvendit të



# Të enjten Kuvendi mblidhet në seancë plenare

PRISHTINË, 17 JANAR - Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka caktuar të hënën agjendën e punës së Kuvendit për këtë javë. Nën drejtimin e kryetarit Glauk Konjufca, kryesia ka vendosur që Kuvendi të mblidhet në seancë plenare të enjten, më 20 janar 2022, në të cilën pritet të shqyrtohen disa projektligje, të zhvillohet një debat, si dhe të shqyrtohen çështje të tjera të

përcaktuara në rend të ditës. Seanca do të fillojë me deklarime jashtë rendit të ditës dhe pyetje parlamentare, për të vijuar me zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare. Në vazhdim të seancës deputetët do të debatojnë lidhur me ngritjen e çmimeve. Pas debatit Kuvendi do të hyjë në pjesën e shqyrtimit të

projektligjeve. Fillimisht pritet të shqyrtohet Projektligji nr. 08/L-101 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin "Projekti i reformës së sistemit të ndihmës sociale në Kosovë", për të vijuar

më tej me shqyrtimin e dytë të tri projektligjeve: Projektligjit nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, Projektligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, si dhe Projektligjit nr. 08/L-057 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/ L-089 për Deminim Humanitar. Seanca pritet të vazhdojë me shqyrtimin e parë

të Projektligjit nr. 08/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, për t'u përmbyllur me shqyrtimin e raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2020. Pas përfundimit të kësaj seance do të vazhdojë seanca me pikat e papërfunduara më 24, 28 dhe 29 dhjetor 2021.



Kosovës ka rikonfirmuar vullnetin e të gjitha partive politike të pozitës dhe opozitës në Kuvend në raport me një proces i cili shkel sovranitetin dhe kushtetutshmërinë e Republikës së Kosovës", ka deklaruar ajo, duke shtuar se i njëjti parim do të përdoret edhe për zgjedhjet në të ardhmen. "Votimi për zgjedhjet, qofshin ato parlamentare apo siç ishte me referendum të një shteti tjetër, apo të shtetasve të tjerë me dy shtetësi, është i paraparë dhe si shumë herë u ritheksua ditën e shtunë në Kuvend. Pra, ekzistojnë metoda si votohet. Si parim dhe si proces është përcaktuar dhe mund të bëhen përgatitjet tashmë dy apo tre muaj para mbajtjes së zgjedhjeve në Serbi në mënyrë që të kuptohet se Kosova është një tërësi territoriale, një shtet i pavarur dhe sovran dhe një ligj i aplikueshëm për të gjithë njëjtë", ka thënë ajo.

## Hyseni: Rezoluta kundër referendumit serb, qyqarllëk i binomit Kurti - Osmani

Ish-koordinatori shtetëror për dialogun, Skender Hyseni, ka kritikuar rezolutën e Kuvendit të Kosovës për ndalimin e mbajtjes së referendumit serb në Kosovë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se kjo rezolutë ka qenë qyqarllëk i binomit Kurti - Osmani. "Askush nuk e ka vënë në dyshim karakterin ani-kushtetues të votimit edhe në territorin e Kosovës, në një referendum të shtetit serb. Rrjedhimisht ndalimi i këtij referendumit ishte obligim kushtetues i qeverisë dhe kjo duhej të ndodhte në koordinim me aleatët dhe miqtë e Kosovës. Është e sigurt se po të kishim kryeministër dhe Ministri të Jashtme do të merrej edhe pajtimi për ndalimin e referendumit. Për t'u arritur ky koordinim dhe pajtim Kurti e



Osmani kanë pasur gati dy muaj kohë. Por, në vend të koordinimit, konsultimeve dhe pajtimit, Kurti dhe Osmani kanë zgjedhur opsionin e demonstrimit të 'sovranitetit të

padiskutueshëm' nën sloganin 'ne nuk kemi nevojë për aleatë e as për miq dhe nuk lejojmë askënd të përzihet në punët tona të brendshme'. 'Ne nuk e shkelim Kushtetutën tonë as për

aleatët', thanë këta të mjerë. Thua se aleatët nuk bëjnë asgjë tjetër veçse çdo ditë kërkojnë nga ne që ta shkelim Kushtetutën", ka shkruar Hyseni.

Ai e ka kritikuar edhe LDK-në për votimin e kësaj rezolute. "Për këtë maskaradë prej seance kuvendore, Kurtit e Osmanit u duhej një pjesë e opozitës në mënyrë që këta të dy të heqin çfarëdo përgjegjësie nga vetja e tyre. Dhe këtë përkrahje e gjetën, ku tjetër pos te servili dhe hipokriti politik, aleati i tyre Lumir Abdixhiku i LDK-së, i cili, me aleancën e tij të heshtur me Kurtin e Osmanin, përkatësisht me servilizmin dhe hipokrizinë e tij politike, e ka infektuar keq edhe një pjesë të LDK-së. Po nënvizoj: Një pjesë të LDK-së", ka shkruar Hyseni.



## Pjesëtarët e FSK-së trajnohen nga ushtarët amerikanë

PRISHTINË, 17 JANAR - Në kuadër të bashkëpunimit me ushtrinë amerikane, njëzetë pjesëtarë të Regjimentit të dytë të Këmbësorisë të Komandës së Forcave Tokësore përfunduan trajnimin njëjavor "Shkathësi malore". Gjatë trajnimit pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës u aftësuan në teknika të ngjijtes në shkëmbinj, evakuimin e viktimave në

terrene të thepisura, kalimin e pengesave ujore dhe repelim. Në Komandën e Forcave Tokësore në Istog u mbajt ceremonia e certifikimit, ku të pranishëm ishin oficerë dhe nënoficerë të FSK-së dhe atyre amerikanë, të cilët vlerësuan lart rëndësinë e trajnimeve të tilla që kanë për qëllim ngritjen e aftësive taktike të pjesëtarëve të FSK-së.



## Inspektorët komunalë lirojnë hapësirat publike në qytetin e Mitrovicës



MITROVICË, 17 JANAR - Drejtoria e Inspeksionit, me asistimin e Policisë së Stacionit Jugor në Mitrovicë, që nga orët e hershme të mëngjesit ka realizuar aksionin për lirimin e të gjitha hapësirave publike në qytet, duke mos lejuar shitësit e ndryshëm, qe mallrat e tyre t'i ekspozojnë ne trotuare dhe në hapësira të tjera publike të parapara për shfrytëzim nga ana e qytetarëve. Për lirimin e këtyre hapësirave ka pasur kërkesa të shumta nga qytetarët të cilët kanë shprehur pakënaqësitë e tyre për pengim të lëvizjes së lirë, derisa inspektorët komunalë nga aksioni i sotëm kanë bërë me dije se shitësit i kane respektuar urd-

hëresat e inspektorëve dhe nuk ka pasur nevojë për intervenim të policisë apo shqiptim të ndëshkimeve mandatore. Lidhur me aksionin e sotëm drejtori i Inspeksionit, Valon Brahimi, ka paralajmëruar se aksione të tilla do të ketë në vazhdimësi derisa te mos ketë ekspozim të mallrave nëpër trotuare dhe te mos ketë pengesa në lëvizjen e qytetarëve. Vlen të potencohet se aksioni është zhvilluar në gjithë zonën urbane të qytetit dhe është mbikëqyruar nga gjithsej katër ekipe të inspektorëve, në mënyrë që lajmërimi i datës 06.01.2022 për subjektet afariste të zbatohet në përpikëri.



## Loti i Nasimit...

Ai lot i Nasimit është lot i dhimbjes krenare, që përvëlooi dhe tmerroi e vrau ndërgjegjen e gjakprishurve. Ai lot është lot i vuajtjes së popullit tonë nga shteti serb e Co.

në shekuj. Ai lot është dhimbja dhe krenaria shekullore e Agronit me gjyshen, e familjes së Smajl Haradinajt në dhomën e spitalit në burg të Pejës dhe i kombit tonë shqiptar.

Burrat si Nasimi e thonë aty ku është vendi e kuvendi, fjalën shqip aty në Hagë, në gjykatë, pa frikë, në mbrojtje të kombit e të luftës sonë të drejtë për liri e çlirim kombëtar. (Nait Hasani)

## Osmani dhe Kurti përkujtojnë Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe Kadri Zekën

DEÇAN, 17 JANAR - Në 40-vjetorin e vrasjes së Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës, kryeministri Albin Kurti, me presidenten Vjosa Osmani Sadriu, kanë vizituar kullën e familjes Gërvalla në Dubovik. Aty u pritën nga Suzana Gërvalla, bashkëshortja e Jusuf Gërvallës dhe Donika Gërvalla, e bija e tij, si dhe familjarë e miq të veprimtarëve të shquar të çështjes kombëtare. Nga aty, kryeministri Kurti, presidentja Osmani dhe zëvendëskryeministrja Gërvalla bënë homazhe dhe vendosen kurorë me lule te varrezat e Jusuf

dhe Bardhosh Gërvallës. "Ne erdhëm sot në Dubovik, në 40-vjetorin e vrasjes së trefishtë në Shtutgart, më 17 janar 1982, kur u vranë Kadri Zeka e Jusuf e Bardhosh Gërvalla, që ta vizitojmë kullën e lindjes, jetës dhe rritjes së tyre, por edhe varrin ku prehen ata, për ta treguar kujtimin e pashlyeshëm dhe nderimin e pafund që kemi për këta heronj, të cilët na e dëshmojnë një luftë edhe para luftës çlirimtare. Meqenëse në vitet e '80 shqiptarët jo vetëm që persekutoheshin e burgoseshin, por edhe vriteshin nga regjimi i atëhershëm okupator, për shkak

se dëshironin liri, republikë, demokraci e përparim", ka deklaruar Kurti. Ai ka theksuar se si institucione do të bashkëpunojnë me shtetet e tjera, në veçanti me Republikën Federale të Gjermanisë, në mënyrë që të marrin vesh sa më shumë e që të zbardhet e vërteta edhe sa iu përket edhe urdhërdhënësve dhe ekzekutorëve. Kryeministri Kurti ka theksuar se janë të vetëdijshëm për kufizimet që kanë, që pas kaq shumë kohësh të arrijnë përnjëherë t'i zbardhin gjithë ato vrasje.





# Ministria e Shëndetësisë bën thirrje për respektim të masave kundër Covidit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 JANAR - Komisioni këshillëdhënës për masat kundër Covid-19 ka mbajtur të hënën takim në Ministri të Shëndetësisë ku ka diskutuar për situatën epidemiologjike në vend dhe për shqyrtimin e masave kundër Covidit që janë në fuqi. Në këtë takim është theksuar nevoja e respektimit të plotë të masave të ndërmarrë më parë përmes mbikëqyrjes së zbatimit të tyre nga të gjitha institucionet përgjegjëse, ndërkohë që popullatës i është bërë thirrje që të vaksinohet plotësisht përfshirë edhe marrjen e dozës përforcuese të vaksinës kundër Covid-19.


Komisioni ka theksuar se janë duke u analizuar indikatorët kryesorë që pasqyrojnë situatën epidemiologjike në vend, ndërsa secili veprim apo masë që do të

propozohet do të ketë për qëllim parandalimin e përhapjes së mëtejme të virusit si dhe parandalimin e formave të rënda të sëmundjes që rritin ngarkesën spitalore dhe vdekjet nga varianti Omicron apo variantet e tjera në qarkullim të SARS COV-2.

MSh-ja thekson se mekanizmat kundër Covidit do t'i marrin për bazë indikatorët shëndetësorë për të propozuar masa sa më adekuate lidhur me Covid-19 në Kosovë. Deri në ndryshimin e masave në fuqi, MSh-ja u bën thirrje qytetarëve që ta rritin kujdesin dhe të vaksinohen pa humbur kohë.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në Kosovë janë regjistruar 728 raste të reja me Covid-19. Rastet e reja dolën pas testimit të 5 297 mostrave, që i bie se 13.74 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë për koronavirus.

Në raportin ditor thuhet se edhe



99 pacientë janë shëruar nga sëmundja Covid-19, ndërkaq raste aktive janë 5 118. Sa i përket vaksinimit, në 24 orët paraprake janë administruar 1 156 doza të vaksinës kundër koronavirusit. Që prej nisjes së fushatës së imunizimit në Kosovë me dy doza të vaksinës janë imunizuar 796 246 persona. Ndërkaq, 33 156 persona kanë marrë dozën përforcuese, ndërkaq me dozë të

tretë janë imunizuar 2 169 qytetarë. Të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat mbi 12 vjeç. Dozën përforcuese dhe atë të tretë mund ta marrin të gjithë personat mbi 18 vjeç, që janë imunizuar me dy doza para tre muajsh.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se Omicroni po shton intensitetin

çdo ditë dhe është varianti dominues në qarkullim.

IKShPK-ja ka bërë me dije se është duke vazhduar vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik.

“Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë ditët në vazhdim, andaj IKShPK-ja apelon te të gjithë qytetarët që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje në veçanti për kujdes dhe mosgrumbullim, ndërsa u rekomandojmë institucioneve përgjegjëse të mbikëqyrin me përpikëri dhe t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë”, ka njoftuar ky institut.

## Rritja e rasteve çon shkollën në mësim online

PRISHTINË, 17 JANAR - Rritja e numrit të rasteve me Covid-19 ka bërë që Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Ismail Qemali” në Prishtinë të kalojë në mësim online. Deri më 17 janar kjo është e vetmja shkollë që ka shkuar në mësim online.

Mimoza Krasniqi, drejtoreshë e shkollës “Ismail Qemali”, ka thënë se nëntë arsimtarë dhe mbi 50 nxënës janë të infektuar me koronavirus.

Testet për Covid-19 që nga 14 janari janë bërë brenda shkollës. “Të hënën, më 17 janar, është vendosur të shkohet në skenarin C - mësim online. Në fillim patëm dërguar në skenarin C dy klasa të ciklit të ulët, pasi që mësuesja ka dalë pozitiv në ato klasa, pastaj kemi kaluar me tri klasa të ciklit të lartë në skenarin C, por pas rritjes së rasteve është vendosur për skenarin C”, ka thënë ajo.

Mësimi online në shkollën “Ismail Qemali” do të mbahet gjatë tërë javës, ndërkohë për javën tjetër prindërit do të informohen me kohë.

Krasniqi ka thënë se janë bërë të



gjitha përgatitjet për mësimin online.

Në sistemin arsimor në Kosovë mësimi në kohë të pandemisë me Covid-19 është i organizuar përmes tre skenarëve.

Skenari A - mësimi në ambientet shkollore. Skenari B apo mësimi i

kombinuar përfshin rikthimin e pjesshëm të nxënësve në shkolla (prani e nxënësve në shkolla, e kombinuar edhe me mësimin në distancë). Dhe skenari C mësimi në distancë apo online.

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

(SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se, përveç shkollës “Ismail Qemali”, mund të ketë edhe shkolla të tjera që do të shkojnë online pasi që numri i të infektuarve po rritet. Ai ka theksuar se mësimdhënësve vazhdon t'u mungojnë kushtet

për mësim online. “Ne kemi kërkuar që mësimdhënësit mësimin online ta bëjnë nga shkolla pasi që edhe mbikëqyrja është më e lehtë, por në rrethanat deri më tani arsimtarët kanë mbajtur mësim online nga shtëpia që ka krijuar vështirësi teknike, siç janë problemet me pajisje, kompjuterë me internet dhe vështirësi të tjera”, është shprehur Jasharaj.

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka ripërsëritur thirrjen për respektim të masave për mbrojtje nga pandemia Covid-19 nga ana e të gjithë aktorëve të përfshirë në institucionet arsimore. “Respektimi me përpikëri i masave të rekomanduara nga ekspertët shëndetësorë, përveç që është domosdoshmëri për mbrojtjen e shëndetit publik, është edhe mundësi më e mirë për ta siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor me prani fizike në shkollë”, ka thënë Nagavci, sipas një komunikate për media më 17 janar.

## Në Klinikën e Onkologjisë vitin e kaluar u trajtuan 1 626 pacientë

Prishtinë, 17 janar - Vitin e shkuar në Klinikën e Onkologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës u trajtuan 1 626 pacientë si raste të reja me sëmundje malinje. “Prej tyre, 400 raste ishin të identifikuar me kancer në gj, 214 raste me kancer në mushkëri, 391 raste me kancer në traktin

gastrointestinal, 419 raste me kancer në sistemin urgjenital dhe gjinekologjik, si dhe 205 raste me kancer në regjionin kokë-qafë”, ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës. Sipas ShSKUK-së, gjatë vitit 2021, gjithashtu, në Klinikën e Onkologjisë ishin të shtrirë 356 pacientë për trajtim. “Nga janari deri

në dhjetor në këtë klinikë janë ofruar mbi 300 mijë shërbime të ndryshme onkologjike, mes tyre 105 seanca të brahiterapisë, mbi 11 mijë seanca të rrezatimit, më shumë se 29 mijë terapi me citostatikë dhe më tepër se 1 000 pacientë janë trajtuar me radioterapi”, ka njoftuar ShSKUK.





# Bizneset që dëmtojnë shtetin



**PRISHTINË, 17 JANAR** - Kafeneja "Tirona", në qendër të Prishtinës, është një prej lokaleve që lëshon rregullisht kuponë fiskalë për klientët e vet. Pronari i saj, Fanol Duli, thotë se kjo praktikë ka nisur prejse kanë hyrë në treg arkat fiskale në Kosovë në vitin 2010. "[Lëshimi i kuponëve fiskalë] ndikon shumë për të keq te bizneset që punojnë në mënyrë të rregullt. Përderisa ne paguajmë në secilin kupon fiskal 18 për qind TVSH [Tatim mbi Vlerën e Shtuar], ata të tjerët që nuk lëshojnë kuponë fitimin e kanë gati 100 për qind, për të mos thënë më shumë", thotë Duli për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, shteti duhet të bëjë më shumë inspektime për kontrollimin dhe ndëshkimin e atyre bizneseve që nuk lëshojnë kuponë fiskalë. "Për të parandaluar këtë pabarazi, inspektimi është e vetmja mënyrë. Në lokal tek unë vijnë shumë dhe është krijuar përshtypja që inspektorët

shkojnë në ato lokale që lëshojnë kuponë fiskalë, që në fund të ditës ta bëjnë një raport, që 'po, bizneset po lëshojnë kuponë fiskalë', e që unë mendoj se është e kundërta, sepse nuk lëshojnë", thotë Duli.

Sipas ligjit në Kosovë, kuponi duhet të lëshohet nga ofruesi i shërbimeve në çdo rast kur arkëtohen pagesa me para në dorë.

Kuponi fiskal është dëshmi e shitjes së mallrave të caktuara dhe ai përfshin edhe tatimin që duhet paguar për mallrat e shitura.

Në rast të moslëshimit të kuponit fiskal, shteti mbetet pa ato taksa.

Taksa për shumicën e mallrave në Kosovë është 18 për qind.

Sipas disa qytetarëve të anketuar nga "Radio Evropa e Lirë" në Prishtinë, pompat e benzinës janë biznese që rrallë lëshojnë kuponë fiskalë. "Kuponi i fundit që e kam marrë ka qenë pardje. Rregullisht në qendra tregtare i

marr, por të tregoj të drejtën në pompa të benzinës nuk kam marrë asnjëherë. E di që disa prej tyre lëshojnë kuponë fiskalë, por unë nuk kam marrë", thotë Ibrahim Kryeziu.

Profesori i ekonomisë, Musa Limani, i cili thotë se ka pasur një përvojë të tillë në pika të karburantit, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se këto raste duhet të paraqiten nga qytetarët. "Kur marr benzinë në pikat e karburantit asnjëherë nuk ma ofrojnë kuponin fiskal. Unë e kërkoj, madje kam pasur problem në këtë drejtim. Prandaj mendoj se të gjithë ata që nuk ofrojnë kuponë fiskalë duhet të lajmërohen si raste që nuk lëshojnë kuponë", thotë Limani.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve, në Kosovë janë 1 002 biznese të regjistruara si pika të karburantit.

Profesori Limani thotë se moslëshimi i kuponëve fiskalë

ndikon në zvogëlimin e buxhetit të shtetit. "Ne duhet ta kuptojmë drejt dhe mirë se ikja prej këtyre obligimeve, moslëshimi i kuponëve fiskalë, dëmton shtetin. Dhe, në këtë mënyrë, zvogëlohen të hyrat buxhetore dhe zvogëlohet mundësia e qeverisë që t'u ofrojë shërbime më të mira publike qytetarëve. Duhet të rritet kontrolli dhe të merren masa shumë të rrepta kundër të gjithë atyre që nuk lëshojnë kuponë fiskalë", thotë ai. Por, në njërin nga kompanitë më të mëdha për furnizim me derivate të naftës në Kosovë thonë se janë të pajisur me arka fiskale dhe se lëshojnë kuponë fiskalë rregullisht. Sipas tyre, kuponi fiskal shtypet në arkën brenda objektit të shitjes. "Nuk ka mundësi të bëhet shitja e radhës pa dalë kuponin fiskal. Për secilën shitje del kuponin fiskal, mirëpo kuponët fiskalë nuk janë te pompat. Klienti e mbush veturën me derivate dhe përton të vijë ta marrë kuponin fiskal

[brenda në objekt]", thotë një punëtor i kësaj kompanie.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, thotë se moslëshimi i kuponëve fiskalë ka bërë që në treg të ketë pabarazi. Sipas tij, Administrata Tatimore e Kosovës duhet të punojë më shumë për ta kthyer barazinë në tregun e Kosovës. "Pjesa kryesore që duhet të ndryshohet është një fokus më i madh i ATK-së në këto probleme dhe një nxitje më e madhe për raportimin e këtyre rasteve. Jo vetëm kontrollime, por veprime të vazhdueshme për t'i fiskalizuar të gjitha bizneset", thotë Rukiqi.

## ATK-ja: Mbi një milion euro dënime në vitin 2021

Mbi 213 000 biznese sa janë të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, vetëm mbi 37 mijë janë të fiskalizuar, sipas ATK-së. Bazuar në këto të dhëna, shumë biznese vazhdojnë t'u ikin obligimeve tatimore që kanë ndaj shtetit.

Zyrtarë të kësaj administrate thonë se në rast se bizneset nuk fiskalizohen, vendosen gjopa konform ligjit. Sipas një përgjigjeje me shkrim të ATK-së dërguar "Radios Evropa e Lirë", vlera e gjobës për mospajisje me arkë fiskale është 1 000 euro, ndërsa dënimi për moslëshim të kuponit fiskal është 125 euro. "Vetëm gjatë vitit 2021 janë vizituar 4 953 biznese për moslëshim të kuponëve fiskalë, ku prej këtyre vizitave janë lëshuar 5 870 dënime në vlerë mbi 1.2 milion euro", thuhet në përgjigjen e ATK-së. Në ATK thonë se kanë partneritet me qytetarët që raportojnë raste të shumta që nuk lëshojnë kuponë fiskalë, por edhe rastet kur në vend të kuponit fiskal lëshohen fatura të tjera jofiskale.

## Fillon punën ndërmarrja shoqërore Brezovica

**PRISHTINË, 17 JANAR** - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka njoftuar se tashmë ka filluar punën ndërmarrja shoqërore Brezovica. Sipas njoftimit të AKP-së, thuhet se më 13 janar 2022 Bordi i Drejtorëve i AKP-së emëroi bordin e ri të përkohshëm menaxhues për NSH Inex Sharr Planina Brezovicë, Shtërpçë, në përbërje të gjashtë anëtarëve. Kjo ndërmarrje me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së ishte vendosur më parë nën

administrimin e AKP-së më 22 dhjetor 2020. "Më 14 janar 2022 menaxhmenti i AKP-së mbajti një mbledhje përmbajtjesore me Bordin e Përkohshëm të Drejtorëve të NSH Inex Sharr Planina Brezovicë. Në këtë mbledhje është biseduar për mbarëvajtjen e punëve në Brezovicë dhe është biseduar gjerësisht për obligimet e Bordit të Brezovicës për t'i përmbushur detyrat e tyre ligjore për funksionimin e tërësishëm të Brezovicës në bazë të ligjeve të

Kosovës, duke përfshirë: Instalimin e arkave fiskale; Raportimin financiar e operativ në AKP; Deklarimin e rregullt të tatimeve tek ATK si dhe zbatimin e ligjeve të Kosovës", thuhet në njoftim.

Po në takim u pajtua që të fillohet sa më të shpejtë sezoni i skijimit, të mbahet bashkëpunimi i mirëfilltë dhe të vazhdohen aktivitetet e ndërmarrjes, me ç'rast i gjithë operimi i ndërmarrjes do të bëhet sipas infrastrukturës ligjore të Kosovës.





# Në kërkim të racës Ariane: Misioni i bujshëm i nazistëve në pyjet e Amazonës



Nga Pietro EMANUELI

Nazistët kishin një koncept racist mbi botën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, brenda së cilës Gjermania ishte qendra e gjithçkaje, dhe ishte mbi të gjithë popujt e tjerë. Siç dihet ky konceptim, do të kishte si rezultat fatal gjenocidin: Holokaustin e atyre popujve të konsideruar si armiq dhe ndotës të pastërtisë së "Herrenrasse", racës Ariane. I njëjti koncept, edhe pse disi më i zbutur nga ezoterizmi, okultizmi dhe misticizmi, do t'i çonte njerëzit e Rajhut të Tretë në cepat më të largët të botës në kërkim të hamajlive, objekteve të shenjta, objekteve të mrekullueshme dhe vendeve legjendare.

Sepse edhe para se të ishte një politikë, nazizmi ishte një fe. Një fe e zhytur në mesianizëm dhe në një dhunë purifikuese. Të shkruash dhe flasësh mbi aspektin misterioz të nazizmit është shumë e rëndësishme -madje thelbësore - sepse vetëm duke analizuar atë që ndodhi prapa skenave të Rajhstagut, mund të kuptosh plotësisht qartësinë e sipërmarrjeve në dukje të çuditshme të Ahnenerbe. Qëllimet e ekspeditave të tilla si kërkimi i Graalit të Shenjtë dhe

Atlantidës mitologjike, ekspedita në Tibet, dhe një mision misterioz në Amazonë, nuk janë sqaruar asnjëherë. Arsyet e ekspeditës naziste në Amazonë, ose siç u njoh në mesin e viteve 1930 "ekspedita e Rio Jari", nuk mund të kuptohen pa një kthim pas në të kaluarën e më shumë se një shekulli më herët.

Sepse kurioziteti gjerman mbi misteret, popullatat dhe thesaret e humbura të Amazonës lindi që në vitin 1821, kur u botua libri "Udhëtim në Brazil" me autor Princin Maksimilian i Vid-Nojvidit. Ai libër ishte rrefimi i një ekspedite pioniere në zemër të pyllit gjigant të Amazonës, i udhëhequr nga vetë Princi Maksimilian, i kryer midis viteve 1815-1817, qëi dha mundësinë të kontaktonte me një nga fiset më pak të njohura të njeriut perëndimor: Botokudos.

Ky fis rrethohet ende sot nga një mister magjepsës, pasi ndodhet në zonat më të largëta të Minas Gerais, dhe sepse është krejtësisht i pastër, i virgjër, dhe po ashtu që i aftë t'u rezistojë të gjitha përpjekjeve për asimilim nga ana e portugezëve. Botokudot ishin të egër në kuptimin e vërtetë të fjalës, dhe luftëtarë të njohur për dhunën e ndaj të huajve.

Gjithsesi, në një farë mënyre,

princi arriti të bëhej njëri prej tyre, duke rrefyer në libër se jetoi 2vjet në shoqërinë e tyre. Libri i Maksimilianit do të ndizte më vonë imagjinatën kolektive gjermane. Dekada më vonë, falë marrëdhënieve të përzemërta midis Brazilit dhe Gjermanisë Naziste, gjermanët do të riktheheshin me një ekspeditë të re në mushkëritë e gjelbra të planetit tonë.

Nazistët e eksploruan Amazonën në vitet 1935-1937. I konceptuar publikisht si një mision për investigimin e lidhjeve midis racës së humbur ariane dhe paraqytetërimeve kolumbiane, ai iu besua një eksploruesi të ri dhe premtues: Otto Shulc-Kampfenkel.

I lindur në vitin 1910, 25-vjeçari kishte tërhequr vëmendjen e organizatës "Ahnenerbe" për shkak të një udhëtimi që kishte kryer i vetëm në Liberi të dokumentuar në një libër, që u vlerësua shumë nga geografët, antropologët dhe zoologët gjermanë.

Hajrih Himleri donte të vidhte sekretet e fiseve të humbura, të pa "ndotura" nga njeriu evropian. Ai mendonte të gjente ndoshta gjurmë të El Dorados mitike, dhe Shulc-Kampfenkel zotëronte gjithçka që i nevojitej Rajhut të

Tretë: gjenialitet, idealizëm, shkathtësi dhe shpirtin e aventurës.

Pasi morën miratimin e presidentit brazilian Getulio Vargas, studiuesit nazistë u nisën për në Brazil në shtator të vitit 1935. Pritshmëritë ishin shumë të mëdha, prandaj misioni u mbështet nga sponsorë të ndryshëm: qeveria braziliane, Ministria gjermane e Propagandës, Shoqëria Kajzer Vilhelm për Përparimin e Shkencave dhe Muzeu Kombëtar i Brazilit.

Shulc-Kampfenkel, u vendos në qendër të vëmendjes së shtypit botëror. Ekspedita ngriti në nëntor 1935 kampin e saj bazë në Santo Antonio da Kaçoeira, afër Gujanës Franceze, për të kaluar më pas në Rio Jari. Të ndihmuar nga një vendas i komunitetit etnik Arapai, i mbiquajtur Uinetu nga nazistët, studiuesit arritën të kalonin kufirin në Guajanën Franceze dhe të banonin përkohësisht në një fshat Aparai.

Përgjatë dy vjetëve, pra deri në vitin 1937, eksploruesit gjermanë bënë zbulime të bujshme, përfshirë zbulimin e grupimeve etnike Uajana dhe Uajapi, që deri atëherë besohej se ishin zhdukur, dokumentuan rite dhe tradita të fiseve të ndryshme, si dhe

grumbulluan artefakte të dobishme për avancimin e kërkimeve etno-antropologjike dhe zoogeografike.

Por në vitin 1937, Shulc-Kampfenkel u detyrua ta ndërpriste punën, duke i urdhëruar kolegët e tij të ktheheshin me shpejtësi në kampin bazë, për shkak të përhapjes së malaries dhe sëmundjeve të tjera tropikale midis anëtarëve të ekspeditës. Ai vetë ra viktimë e epidemisë, duke vuajtur nga një formë e rëndë e difterisë.

Të lodhur, të sëmurë dhe të demoralizuar - një anëtar i ekipit vdiq rrugës - njerëzit e stafit të Shulc-Kampfenkel u rikthyen në Gjermani në maj me qindra orë filmime dhe mijëra gjetje zoologjike - disa prej të cilave janë ende të ekspozuara sot në Muzeun e Historisë Natyrore në Berlin - dhe artefakte vendase.

Aventurat e nazistëve në Amazonë i dhanë famë dhe pasuri Shulc-Kampfenkel, filmimet e të cilit u bënë një film artistik 90-minutësh prodhuar nga kompania "UFA" ndërsa kujtimet e tij u bënë një libër bestseller në vitin 1938. / "Il Giornale" - Bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Stinori pranveror fillon me duele shumë interesante

**PRISHTINË, 17 JANAR** - Në mesjavë zhvillohet xhiroja e tetë në Ligën Unike në konkurrencën e meshkujve, që është e para për stinorin pranveror. Sfida e parë zhvillohet në mes të Pejës dhe Teutës së Durrësit. Ky është një nga takimet më interesante në këtë xhiro për shkak se pejanët kanë pesë fitore dhe dy humbje, kurse durrsakët katër fitore dhe tri humbje. Në takimin e parë në mes të këtyre dy skuadrave fitore kishin shënuar verdhezinjtë 73:82. Lideri dhe kampioni Golden Eagle Ylli do të sfidohet nga Vllaznia e Shkodrës. Therandasit kanë gjashtë fitore dhe një humbje, ndërsa shkodranët një fitore dhe gjashtë humbje. Përballje e barabartë shihet ndërmjet Rahovecit dhe Neptun Tiranës. Vreshtarët u këndellen me



dy fitore, ndërsa kanë edhe pesë humbje, kurse kryeqytetasit e Shqipërisë kanë katër fitore dhe tri humbje. Tiranasiit kishin fituar duelin e parë 79:74. Duelli i fundit i xhiros është mes Kamza Basket

dhe Prizrenit 16. Në sfidën e parë kishte fituar skuadra nga Kamza me rezultat 91:96. Kamza ka dy fitore dhe pesë humbje, kurse prizrenasiit kanë katër fitore dhe tri humbje.

### Liga Unike - Java 8

#### Të martën takohen:

17:00 Peja - Teuta  
19:00 Golden Eagle Ylli - Vllaznia

#### Të mërkurën takohen:

17:00 Rahoveci - Tirana Neptun  
19:00 Kamza - Prizreni 16

## Khaka: Emocioni më i madh në karrierë ishte goli ndaj Serbisë

**LONDËR, 17 JANAR** - Ylli i Arsenalit, Granit Xhaka, është rikthyer të flasë sërish për golin e shënuar për Zvicrën në ndeshjen kundër Serbisë. Zvicra para disa viteve bëri hapin e madh duke mposhtur Serbinë me rezultat 1 - 2, ku dy golat i shënuan Xherdan Shaqiri dhe Granit Xhaka. Dje, derisa ishte drejtpërdrejt në "TikTok", Xhaka është pyetur lidhur me këtë ndeshje. Ai tha se është ndeshja që ka pasur emocionet më të mëdha sidomos pas golit të shënuar dhe festës me shqiponjë. "Emocioni më i madh deri sot në karrierën time ka qenë loja ndaj Serbisë në Rusi, ku dhashë edhe unë gol, por edhe Shaqiri. Ato kanë qenë emocionet që nuk mund t'i përshkruash me fjalë. Shqiponja e bërë ka qenë spontane", ka thënë Xhaka. Xhaka foli edhe për kartonin e kuq që mori së fundmi ndaj



Liverpoolit. Ai e pranoi se ishte fajtor. "Ka qenë një faull shumë gjigant. S'ka faj ai (arbitri), ke për karton të

kuq. Unë jam shumë real, e pranoj kur është karton i kuq dhe kur jo", ka shtuar Xhaka.

### SHKURT

#### Mourinho: Isha shumë i ashpër me Kumbullën, bëri ndeshje fantastike

Jose Mourinho bën prapakthehu për mbrojtësin Marash Kumbullën dhe e bën në stilin e tij pas fitores 1-0 ndaj Cagliarit. Deklaratat publike kundër lojtarit shqiptar janë kthyer në elozhe publike për mbrojtësin e ri i cili po e bind gjithnjë e më shumë portugezin te Roma. "Si fillim dua të flas për Kumbullën. Për mua ai ishte më i miri, ka bërë një ndeshje fantastike dhe kjo më bën të lumtur pasi ka kaluar një periudhë të vështirë dhe unë kam qenë shumë i ashpër me të në deklarata dhe stërvitje. Por ai ka qenë gjithmonë shumë i qetë dhe i përlulur. Është rritur shumë. Ai dhe Mançini kanë bërë mirë, por edhe mesfushorët e qendrës kanë bërë mirë mbulimin, ndryshe nga ajo që kishte ndodhur me Juventusin", ka thënë Mourinho.

#### Dren Spahiu fiton 154 pikë në garën e Kronplatzit

Dren Spahiu është emri i radhës nga skitaria që ka nisur të shënojë rezultate ndërkombëtare. Garuesi i Kosovës ka arritur të fitojë 154 pikë të Federatës Ndërkombëtare të Skitarisë (FIS) në garën e Kronplatzit të Italisë, të mbajtur të dielën, disiplina e sllallomit të madh. Pikët e fituara janë të ngjashme për një kriter të normës olimpikë, që dëshmojnë se e ardhmja e Drenit është e ndritshme, kurse rezultatet e tilla kontribuojnë për plotësimin e kriterëve për pjesëmarrje në Kampionatin Botëror. Dreni pritet ta përfaqësojë Kosovën edhe në Festivalin Olimpik Evropian Dimëror "Vuokatti 2022", që në muajin mars mbahet në Vuokatti të Finlandës.

#### Maxwell, MVP i xhiros së 16-të

Lojtari më i dalluar në parket për derbin e javës së 16-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll ishte Stephen Maxwell i Pejës me 34 pikë, dhjetë kërcime dhe tri asistime, madje ndaj tij janë shkaktuar 13 gabime personale. Maxwell u ndihmua nga Tyrone White me 32 pikë, pesë kërcime dhe dhjetë asistime. Të dy lojtarët janë ndër më të dalluarit te skuadra verdhezi që nga transferimi i tyre. Një sfidë shumë interesante ishte edhe në mes të Trepçës dhe Prizrenit 16, ku fituan mysafirët 80:94. Te prizrenasiit i jashtëzakonshëm ishte Courtney Fells me 31 pikë, 14 kërcime dhe tri asistime. Në momentet vendimtare Fells dëshmoi aftësitë e tij, duke ndihmuar skuadrën prizrenase të shënojë një fitore shumë të rëndësishme. Rahoveci shënoi fitore më të vështirë se që është pritur ndaj Dritës, 103:90. Më i dalluari te Vreshtarët ishte Milik Yarbough me dyshifrorë të trefishtë, 23 pikë, 11 kërcime dhe 10 asistime. Golden Eagle Ylli shënoi fitore ndaj Bashkimit 78:61, ku u dallua Henrik Sirko me 19 pikë, pesë kërcime dhe nëntë asistime. Top pesëshja: Stephen Maxwell (Peja) 34 pikë, 10 kërcime, 3 asistime, Tyrone White (Peja) 32 pikë, 5 kërcime, 10 asistime, Courtney Fells (Prizreni 16) 31 pikë, 14 kërcime, 3 asistime, Milik Yarbough (Rahoveci) 23 pikë, 11 kërcime, 10 asistime, Henrik Sirko (Golden Eagle Ylli) 19 pikë, 5 kërcime, 9 asistime.



## Nadali debuton me fitore, Osaka nis me triumf mbrojtjen e titullit

Melbourne, 17 janar - Grand slami i Australian Openit ka luajtur ndeshjet e para të raundit të parë. Kampionia në fuqi për femra, tenistja japoneze Naomi Osaka, fitoi me rezultat 2-0 (6-3, 6-3) ndaj kolumbianes Maria Osorio,

duke avancuar më tej. Në raundin e dytë shkon edhe tenistja ukrainase Elina Svitolina, që mundi 2-0 (6-1, 7-6) francezen Fiona Ferro. Surprizë eliminimi i amerikanes Cori Gauff, që u mund 2-0 nga kinezja Qiang

Wang. Nuk zhgënjën numri 5 në botë, tenistja greke Maria Sakkari, që mundi 2-0 gjermanen Tatjana Maria. Në raundin e dytë shkojnë edhe tenistja çeke Barbora Krejčíková (numri 4 në botë), bjellorusja Victoria Azarenka,

zvicëria Belinda Benčić. Ka nisur me fitore aventura në Australian Open e tenistit spanjoll Rafael Nadal, që mundi me rezultat 3-0 amerikanin Marcos Giron (6-1, 6-4, 6-2). Më tej shkon edhe italianin Matteo Berrettini



(numri 7 në botë), që mundi 3-1 amerikanin Brandon Nakashima.

## Tahiri do ta përfaqësojë Kosovën në katër disiplina në garën me ski në Pekin 2022

Prishtinë, 17 janar - Albin Tahiri edhe zyrtarisht do ta përfaqësojë Kosovën në katër disiplina të garës me ski në Lojërat Olimpikë Dimërore Pekini 2022, që nisin muajin e ardhshëm. Tahiri, i cili është atleti i parë që e përfaqësoi Kosovën në Lojëra Olimpikë Dimërore, ishte në kërkim të sigurimit të pjesëmarrjes edhe në garën e super slallomit të madh. "Është zyrtare tani, unë do të jem në gjendje të garoj në katër disiplina. Fatkeqësisht, nuk ia dola në super slallom të madh", ka thënë Tahiri, i cili do të garojë nën flamurin e Kosovës në katër disiplina të garës me ski: lëshim, kombinim alpin, slallom të madh dhe slallom. Ai u shpreh krenar që tani renditet në pozitën e 316 në botë në garën e lëshimit, e cila ia mundëson pjesëmarrjen në Pekin 2022. "Dëshiroj ta falënderoj Komitetin Olimpik të



Kosovës dhe Federatën e Skitarisë së Kosovës për mundësinë që ma dhanë për të marr pjesën në Lojërat Olimpikë për herë të dytë. Do të përpiqem t'ua shpagoj këtë me paraqitje sa më të mira", ka shtuar ai. Tahiri do ta përfaqësojë Kosovën në Lojërat Olimpikë Dimërore për

herë të dytë. Lojërat Olimpikë Dimërore do të mbahen nga 4 deri më 20 shkurt 2022 në Pekin të Kinës. Para dy vjetëve Tahiri u bë sportisti i parë që e përfaqësoi Kosovën në Lojëra Olimpikë Dimërore duke marrë pjesë në PyeongChang 2018 në Korenë e Jugut.

## Tjetër zhgënjim për Golden State, triumfojnë Phoenixi dhe Utah Jazz

MINNESOTA, 17 JANAR - Golden State nuk po kalon çaste të mirë në NBA, teksa është mposhtur me rezultat 119-99 nga Minnesota, humbja e katërt në 10 takimet e fundit. Takim i dominuar nga vendasit, ku u dallua Towns me 26 pikë e 11 rebounde, ndërsa për Warriorsin mungoi Curry. Nga kjo situatë përfiton Phoenixi, që fitoi 135-108 në fushën e Detroitit dhe nis shkëputjen në Perëndim. Booker realizoi 30 pikë, mbështetur nga McGee e Payne me nga 20 pikë



secili, një treshe që bëri diferencën për Phoenixin. Në vendin e tretë në Perëndim ndodhet Utah Jazzi, që sot mposhti 125-102 Denverin, sfidë ku u dallua Mitchell me 31 pikë

(Jokic realizoi një triple double për Denverin). Fitoi edhe Houstoni, 118-112 ndaj Sacramentos, me dyshen Wood e Porter që realizuan nga 23 pikë secili.

### REZULTATET

Detroit - Phoenix	108-135
Sacramento - Houston	112-118
Minnesota - Golden State	119-99
Denver - Utah Jazz	102-125

## Song: Nuk më interesonte që nuk luaja te Barça, doja vetëm milionat

Alex Song ka zbuluar së fundmi se lëvizja e tij nga Arsenalit te Barcelona në vitin 2012 ndodhi për shkak financiar. Mesfushori kamerunas me singjeritetin

më të madh tregon se atij nuk i interesonte fakti se te katalanasit po qëndronte në stol, por i mjaftonte fakti se prej kontratës me spanjollët ishte duke u pasuruar

gjithnjë e më shumë. "Kur Barcelona më ofroi një kontratë, pyeta menjëherë se sa do të fitoja. Nuk e mendova dy herë pasi doja që gruaja dhe fëmijët e mi të

mos kishin probleme kur unë ta lija futbollin. Takova drejtorin e Barcelonës dhe ai më tha se nuk do të luaja shumë ndeshje, megjithatë nuk më interesonte. Unë e

dija se do të bëhesha një milioner. Unë mund të bëja pazare për çdo ditë dhe të shkoja të argëtohesha në çdo mbrëmje", ka deklaruar Song.

### SHKURT

#### Ancelotti: Pas Superkupës, koha për titujt e tjerë

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, pas triumfit të Superkupës së Spanjës ndaj Athletic Bilbaos (0-2), u ka bërë thirrje lojtarëve të vet të përqendrohen në trofetë e mbetura të sezonit. Reali e mposhti Bilbaon me golat e Luka Modriqit dhe Karim Benzemas. "Ky është ekip shumë i mirë dhe jam krenar që jam trajner i tij. Tani do të vazhdojmë të garojmë në garat e tjera. Ndeshjen e radhës e kemi të enjten (për Kupën e Mbretit) e cila është e rëndësishme", ka thënë Ancelotti. Real Madridi është lider në La Liga me 49 pikë dhe është në 1/8 e finales në Ligën e Kampionëve.

#### Romagnoli mposhti Covidin

Trajneri Stefano Pioli ka marrë një lajm shumë pozitiv paraditen e sotme teksa ka mësuar se një nga lojtarët e skuadrës është rikuperuar nga Covid-19. Alessio Romagnoli ka rezultuar negativ ndaj Covid-19. Romagnoli do të kthehet në stërvitjet e Milanit që nga dita e nesërme dhe ai do të jetë i gatshëm për sfidat e radhës. Lajmin e ka bërë me dije vetë klubi i Milanit nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, teksa theksohet se do të jetë i gatshëm lojtari që në ndeshjen e radhës.

#### Firmino, në 'radarin' e Barcelonës

Skuadra e Barcelonës mbetet në kërkim të një sulmuesi. Pista Morata ra përfundimisht me Juventusin që e konsideron të pashitshëm, për këtë arsye Xavi u ka propozuar drejtuesve të klubit një tjetër emër. Sipas "El National", tekniku blaugrana kërkon në "Camp Nou" sulmuesin e Liverpoolit, Roberto Firmino. Brazilianit i skadon kontrata në verën e vitin 2023, por në përfundim të këtij sezoni të kuqtë mund të futen në negociata me çdo klub që kërkon shërbimet e tij pasi në të kundërt mund ta humbasin falas. Barcelona është e gatshme të investojë 20 milionë euro për t'i siguruar shërbimet e Firminos.

#### Sampdoria shkarkon trajnerin

Roberto D'Aversa nuk është më trajner i Sampdorias. Klubi italian e ka shkarkuar 46-vjeçarin për shkak të rezultateve negative. Sampdoria renditet në vend të 15-të me 20 pikë, katër mbi zonën e ftohtë. Humbja 1-2 kundër Torinos ka qëlluar fatale për D'Aversa. Me anë të një komunikate zyrtare klubi i Serisë A ka lajmëruar ndërprerjen e bashkëpunimit me teknikun italian. D'Aversa mori drejtimin e Sampdorias në muajin korrik dhe drejtoi ekipin në 24 ndeshje, 22 në kampionat dhe dy në Kupën e Italisë. Marco Giampaolo përflitet se do të jetë trajneri i ri i Sampdorias. 54-vjeçari ka drejtuar këtë skuadër edhe në periudhën korrik 2016-qershor 2019.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Len Communication” SH.P.K. Gjilan, Egzon Reçani ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811583732 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Len Communication” D.O.O. Gnjilane, Egzon Reçani donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811583732, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Len Communication” L.L.C. Gjilan, Egzon Reçani has come to the decision to quit its business: 811583732, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Kujtim Memaj shpall te pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Dema Balaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.

► Lulzim Xhafiqi shpall te pavlefshme 3 dëftesa, diplomën , certifikatën e notave dhe mungesave shmlt "11 Marsi " Prizren.

► “ADE-MAN” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 810039629.

► Qemal Hoti Dejne KK Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat e kl, I,II, III,IV dhe diplomën e Gjimnazit “12 Maji” Ratkoc KK Rahovec.

► Kosovare Makshana Drenoc KK Rahovec shpall të pavlefshme dëftesat e kl, X,XI,XII dhe diplomën SH.M. Teknike “ Nexhmedin Nixha” Gjakovë-Dizajn .

► Mikel Ibishaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI, XII dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

► Egzon Pruthi nga Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. “Selman Riza” Gjakovë.

► Eron Mehmeti shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës se 10-te te SHMLT "Arkitekt Sinani".

► D.P.T " Erza" Shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 70046338.

► Kimete Xhafa shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Rifat Vidishiqi" .

► Qendrim Kajtazi shpalle tre pavlefshme diplomën e SHMLT "Anton Ceta".

► Nazmi Kajtazi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".

► Xhevat MAnjollli shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Azem Bejta".

► Ilir Sa .Sylejmani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 811495284

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

